



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201501400/13

Tiranë ___/___/2017

Lënda: *Rekomandohet propozimi për miratim në Këshillin e Ministrave të rregullave për mënyrën e organizimit e të funksionimit të transportit të punonjësve të Policisë së Burgjeve*

Drejtuar: **Ministrit të Drejtësisë**
Z. Petrit VASILI

TIRANË

I nderuar Z. Vasili,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesë disa punonjës të policisë së burgjeve, të cilët më parë kryenin shërbim në IEVP në Rrugën "Jordan Misja", Tiranë dhe aktualisht janë të emëruar me detyrë në IEVP Fier. Këta punonjës pretendojnë se, kosto e transportit nga Tirana për në vendin e punës përballohet nga vetë ata dhe se ky shpenzim nuk mbulohet nga punëdhënësi.

Referuar nenit 15 pika 5 të Ligjit Nr. 10032, datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve", "punonjësit e Policisë së Burgjeve, të cilët janë të punësuar në IEVP-të që ndodhen larg qendrave të banimit, u garantohet transporti falas vajtje-ardhje nga vendi i punës (IEVP) vetëm për efekt shërbimi. Rregullat e hollësishme për mënyrën e organizimit e të funksionimit të transportit përcaktohen me VKM, me propozim të Ministrit të Drejtësisë".

Për të verifikuar nëse zbatohet përcaktimi ligjor i lartpërmendur jemi interesuar në IEVP Fier, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Ministrinë e Drejtësisë. Nga përgjigjet që kemi marrë ka rezultuar se, për punonjësit e rolit bazë nuk bëhet pagesë transporti, pavarësisht nga vendbanimi i tyre. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka dërguar disa propozime në Ministrinë e Drejtësisë për kompesimin e shpenzimeve të transportit të punonjësve të Policisë së Burgjeve por, deri më sot Ministria e Drejtësisë nuk ka dërguar ndonjë propozim për miratim në Këshillin e Ministrave.

Për sa më lart, bazuar në Nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut" si dhe në

mbështetje të Nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” (me ndryshimet përkatëse) ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”

JU REKOMANDOJMË:

Propozimin për miratim në Këshillin e Mnistrave të rregullave për mënyrën e organizimit e të funksionimit të transportit të punonjësve të Policisë së Burgjeve.

Në bazë të Nenit 22 të Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", lutemi të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI